FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 46

Tiranë – E hënë, 23 mars 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.242, datë 22.3.2020	Për disa shtesa në vendimin nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit".....	3205

VENDIM
Nr.242, datë 22.3.2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.203, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT QË PËRDOREN PËR LIDHJEN E KONTRATAVE QË DIKTOHEN NGA INTERESA THELBËSORË TË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 79 e vijues të Kodit Civil , të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", të ndryshuar, të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", dhe të ligjit nr.10107, datë 30.3.3009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet kreu VIII, me këtë përmbajtje:

"VIII DISPOZITA KALIMTARE PËR PROCEDURAT QË LIDHEN ME EPIDEMINË E SHKAKTUAR NGA INFEKSIONI COVID-19

1. "Autoritetet kontraktore", të referuara në shkronjën "a", të kreut III, të këtij vendimi, janë Kryeministria, të gjitha ministritë dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të deleguara me urdhër të ministrit përkatës.

2. Për procedurën e drejtpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi, nuk zbatohen dispozitat e parashikuara për procedurën e ankimit.

3. Komisioni i vlerësimit, i përcaktuar në pikën 2, të kreut V, të këtij vendimi, kryesohet nga një nëpunës i nivelit drejtues të lartë të autoritetit kontraktor dhe ka në përbërje të tij nëpunës me arsim të lartë.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 28 lekë